



Republika e Kosovës / Republika Kosovo / Republic of Kosovo


Kuvendi Komunal Rahovec / Skupština Opštine Orahovac / Municipal Assembly Rahovec



Drejtoria për Urbanizëm, Planifikim dhe Mbrojtje të Mjedisit

Uprava za Urbanizam, Planiranje i Zastitu Okoline

Department for Urbanism, Planning and Environment Protection



PROCESVERBAL

Nga takimi i shqyrtimit publik me qytetarë për Draft-Hartën Zonale të Komunës së Rahovecit 2026–2034,

Vendi i mbajtjes së takimit: Objekti i Shkollës në Xërxë

Data: 07.08.2026

Ora: 10:30

Tema: Prezantimi dhe shqyrtimi i Draft-Hartës Zonale të Komunës së Rahovecit, me fokus në territorin e fshatrave Xërxë, Fortesë, Sapniq, Pataqan i Poshtëm dhe rrethinë.

Të pranishëm

Në takim morën pjesë përfaqësues të Komunës së Rahovecit, përkatësisht:

Albnor Mullabazi – Drejtor i Drejtorisë për Urbanizëm, Planifikim dhe Mbrojtje të Mjedisit;

Shpejtim Mustafa – zyrtar i Drejtorisë për Urbanizëm, Planifikim dhe Mbrojtje të Mjedisit;

Selim Metkambberi – Shef i Sektorit të Urbanizmit;

Behar Thaqi – Drejtor i Drejtorisë për Bujqësi, Pylltari dhe Zhvillim Rural;

Qytetarë dhe banorë të fshatrave Xërxë, Fortesë, Sapniq, Pataqan i Poshtëm dhe rrethinë.

HAPJA E TAKIMIT

Takimin e hapi Albnor Mullabazi, Drejtor i Drejtorisë për Urbanizëm, Planifikim dhe Mbrojtje të Mjedisit, i cili i përshëndeti të pranishmit dhe i falënderoi për pjesëmarrjen.

Në fjalën hyrëse u theksua se qëllimi i takimit është informimi më i detajuar i qytetarëve lidhur me Draft-Hartën Zonale të Komunës së Rahovecit 2026–2034, si dhe krijimi i mundësisë për qytetarët që të

paraqesin komentet, sugjerimet dhe vërejtjet e tyre gjatë periudhës së shqyrtimit publik. U theksua se Draft-Harta Zonale mbështetet në objektivat dhe përcaktimet e Planit Zhvillimor Komunal, si dhe është hartuar në përputhje me legjislacionin në fuqi dhe dokumentet përkatëse të planifikimit hapësinor në nivel lokal dhe qendror. Gjithashtu, u theksua se qëllimi i dokumentit është krijimi i një baze për zhvillim të qëndrueshëm urban dhe hapësinor të Komunës së Rahovecit, duke përcaktuar destinimin dhe mënyrën e shfrytëzimit të territorit.

PREZANTIMI I DRAFT-HARTËS ZONALE

Në vazhdim të takimit, u bë prezantimi i Draft-Hartës Zonale, me fokus të veçantë në territorin e fshatrave Xërxë, Fortesë, Sapniq, Pataqan i Poshtëm dhe rrethinë. Gjatë prezantimit u sqarua se Draft-Harta Zonale përbëhet nga: pjesa tekstuale; dhe pjesa hartografike/grafike.

U sqarua se pjesa tekstuale përmban përcaktimet, kriteret, kushtet dhe rregullat për zhvillimin dhe shfrytëzimin e territorit, ndërsa pjesa hartografike paraqet në mënyrë grafike zonat dhe destinimet e përcaktuara në territorin e Komunës së Rahovecit. Po ashtu, qytetarëve iu prezantua Harta e Shfrytëzimit të Tokës, përmes së cilës u mundësua shqyrtimi më i detajuar i zonave dhe parcelave konkrete.

Gjatë takimit u bë e ditur se përgatitja e Draft-Hartës Zonale ka kaluar nëpër disa faza të punës dhe konsultimeve. Pas përgatitjes së draft-dokumentit, ai është proceduar për shqyrtim në ministrinë përkatëse dhe, pas marrjes së pëlqimit përkatës, është hapur procedura e shqyrtimit publik.

U sqarua se periudha e shqyrtimit publik zgjat 30 ditë, gjatë së cilës qytetarët, institucionet, profesionistët dhe palët e tjera të interesuara kanë të drejtë të paraqesin: vërejtje, komente, sugjerime.

U theksua se të gjitha komentet dhe sugjerimet e pranuar do të shqyrtohen dhe vlerësohen nga komisioni përkatës, në përputhje me procedurat ligjore.

Pas përfundimit të shqyrtimit publik dhe trajtimit të komenteve, dokumenti do të procedohet për shqyrtim në ministrinë përkatëse dhe, pas përfundimit të procedurave të nevojshme, do të procedohet për miratim në Kuvendin Komunal të Rahovecit.

Gjatë takimit, qytetarët e pranishëm patën mundësi të njihen më nga afër me përcaktimet e Draft-Hartës Zonale për territorin e tyre. Në veçanti, u mundësua shqyrtimi i Hartës së Shfrytëzimit të Tokës dhe identifikimi i parcelave dhe zonave konkrete në territorin e fshatrave të përfshira në këtë takim.

Përfaqësuesit e Komunës sqaruan se gjatë periudhës së shqyrtimit publik qytetarët mund të paraqesin me shkrim komentet, sugjerimet dhe vërejtjet e tyre lidhur me Draft-Hartën Zonale. Në përfundim të takimit, përfaqësuesit e Drejtorisë për Urbanizëm, Planifikim dhe Mbrojtje të Mjedisit falënderuan qytetarët për pjesëmarrjen dhe interesimin e treguar për Draft-Hartën Zonale të Komunës së Rahovecit. Qytetarët u informuan se mundësia për paraqitjen e komenteve, sugjerimeve dhe vërejtjeve mbetet e hapur gjatë gjithë periudhës së përcaktuar për shqyrtim publik. U theksua se të gjitha kontributet e pranuar do të trajtohen në kuadër të procedurave të përcaktuara ligjore dhe do të merren në konsideratë gjatë finalizimit të dokumentit.

Takimi përfundoi në orën 11:15.

Foto nga takimi dhe lista e pjesëmarrësve

